

RAPORTI I NDËRMJETËM

“VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE LOKALE TE 21 QERSHORIT 2015”

Tiranë, Shqipëri 11 Qershor 2015

**Raporti mbulon punën e kryer nga skuadra e 90 vëzhguesve afatgjatë dhe të angazhuar nga Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qendrueshme
Nga data 22 Maj 2015 – 6 Qershor 2015**



Ky raport u realizua në kuadër të projektit: Vëzhgimi i Zgjedhjeve Lokale të 21 Qershorit 2015 në Shqipëri”. Projekti i KZLNQ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015 mbështetet nga Assist Impact nëpërmjet fondeve të USAID-it. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Qendrës “Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qëndrueshme” dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht këndvështrimin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Nderkombëtar (USAID) apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Të drejtat e publikimit

©Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë apo një pjesë të këtij manuali duhet të bëhen në:

Zyrën e Koalicionit për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qëndrueshme
Rr.“Abdyl Frashëri”, P.10/1, shk.1, ap.3, Tiranë, Shqipëri

e-mail: kzln@kzln.org.al

www.kzln.org.al

Tabela e Përmbajtjes

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. PLANI I VËZHIMIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË 21 MAJ 2015	7
2.1 PLANI I VEPRIMIT PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE.....	7
2.2 PLANI I VEPRIMIT PËR DITËN E ZGJEDHJEVE.....	7
2.3 PLAN I VEPRIMIT PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE.....	8
2.4 KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN.....	8
3. SITUATA POLITIKE	8
4. LEGJISLACIONI DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE.....	9
4.1 KUADRI LIGJOR.....	9
4.2 ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	10
4.3 KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ)	11
4.4 KOLEGJI ZGJEDHOR	13
5. ANALIZË E PERIUdhËS DY-JAVORE DHE GJETJET	14
5.1 AKTIVITETI I KZAZ-VE	14
5.1.1 Aktiviteti i KZAZ-ve.....	14
5.1.2 Proceduraliteti dhe vendimmarrja.....	14
5.1.3 Selitë e KZAZ-ve, infrastruktura, logjistika dhe burimet në dispozicion të KZAZ-ve	15
5.1.4 Tabelë e KZAZ-ve me problematika të ndara në dy grupime	16
5.1.5 Krijimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit.....	17
5.2 FUSHATA ZGJEDHORE	17
5.3 INSTITUCIONET PUBLIKE DHE PËRDORIMI I FONDEVE NË KUADËR TË ZGJEDHJEVE LOKALE 2015	20
6. KUSH ËSHTË KZLNDQ	22
ANEKSI 1 TABELA E KZAZ-VE NË TË GJITHË SHQIPËRINË	23

Shkurtime

APPD	Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet
ASHE	Aleanca për Shqipërinë Evropiane
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZAZ	Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor
KZLNDQ	Koalicioni për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme & Demokraci të Qendrueshme
LSI	Lidhja Socialiste për Integrim
OSBE/ODIHR	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë/Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
PD	Partia Demokratike
PR	Partia Republikane
PS	Partia Socialiste
QV	Qendër Votimi
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor

1. Përmbledhje ekzekutive

Në 22 maj 2015 Koalicioni për Zgjedhje të Lira, të Ndershme dhe për Demokraci të Qëndrueshme nisi vëzhgimin parazgjedhor duke stacionuar 90 vëzhgues afatgjatë (VAGJ) për secilin nga Zonave të Administrimit Zgjedhor (ZAZ). Ky raport paraqet gjetjet kryesore për periudhën nga 22 maj 2015, kur fushata elektorale nisi zyrtarisht deri më 6 qershor 2015.

Administrata Zgjedhore (KZAZ-të e KQV-të)

- Njëmbëdhjetë (11) nga nëntëdhjetë (90) Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) janë vendosur në objekte që përdoren nga administrata publike, dhe jo në institucionet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor sic janë ato të kujdesit shëndetësor, arsimor dhe ato kulturore.
- Pothuaj të gjithë komisionerët janë punonjës me kohë të plotë, gjë e cila i pengon që t'i dedikojnë kohë të mjaftueshme funksionimit dhe detyrave që kanë si anëtarë të KZAZ-ve. Kjo sjell vonesa në pothuaj të gjitha veprimet e KZAZ-ve.
- Në njëzet e pesë (25) KZAZ është praktikë e zakonshme që mbledhjet dhe për rrjedhojë vendimet të merren me telefonata midis anëtarëve të KZAZ-ve apo mbledhjet të mbahen në mjedise jashtë zyrës së KZAZ-së.
- Megjithëse Kodi Elektorale përcakton që mbledhjet e KZAZ janë publike, në shumicën e rasteve komisionerët nuk lejuan pjesëmarrjen e personave të tjerë në takime, përfshirë vëzhguesit afatgjatë të KZLN-DQ-së, pa paraqitur akreditimin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).
- Komisionerët të cilët janë propozuar nga partitë e ndryshme politike, zëvendësohen shpesh. KZLN-DQ shpreh shqetësimin se zëvendësimi i shpeshtë sjell një numër të konsiderueshëm komisionerësh pa trajnimin e nevojshëm, referuar datës 4 qershor kur KQZ ka marrë kërkesë për të ndryshuar komisionerët, edhe pse trajnimi i fundit u krye në datën 3 qershor.
- Tridhjetë nga nëntëdhjetë (90) KZAZ kanë problem me furnizimin me bazë materiale sic janë formularët e nevojshëm për punën e tyre, letra, bojë printer, naftë, telefon etj.
- 26 KZAZ nuk kanë marrë akoma buxhetin e nevojshëm për të mbuluar kostot e aktiviteteve të tyre.
- Në total rreth gjysma e KZAZ-ve, 46 prej tyre, kanë të paktën një mungesë në lidhje me bazën materiale, buxhetet ose trajnimin e duhur për komisionerët, kjo më sipër e deklaruar nga vetë komisionerët.
- Në shumicën e rasteve të sipërpërmendura komisionerët përpiqen ti mbulojnë mangësitë në bazën materiale dhe në buxhete nga shpenzimet e tyre personale
- Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD) kanë përmbushur kërkesën e Kodit Elektorale në lidhje me përfaqësimin gjinor në komisionet zonale zgjedhore administrative me rreth 30% gra komisionere.
- Në pozicione drejtuese, kemi vetëm 14 gra si kryetare të emëruara, 19 zëvendës kryetare dhe si dhe 22 sekretare.

- Në 36 KZAZ, u shkel afati i fundit 01.06.2015 për krijimin e komisioneve të qendrave të votimit. Disa arsye për këtë janë që në njëzet e tetë (28) KZAZ, subjektet elektorale vonuan dorëzimin e listave me emrat e kandidatëve për komisionerë të qendrave të votimit. Gjithashtu kishte vonesa në dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, apo në zëvendësimin e kandidatëve për komisionerë që u vlerësua që nuk përmbushnin kriteret.
- Afati për krijimin e komisioneve të qendrave të votimit u shkel në njëmbëdhjetë (11) KZAZ për shkak të problemeve me adresat e qendrave të votimit.

Fushata Zgjedhore

- Në bazë të Kodit Elektorale fushata zgjedhore duhet të fillonte më 22 maj 2015. Vëzhguesit e KZLNDQ kanë vënë në dukje se PS, PD dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) e shkelën këtë kërkesë, pasi e filluan fushatën përpara datës së caktuar, duke zhvilluar ture elektorale të liderve të partive në qytetet kryesore;
- Vëzhguesit e KZLNDQ vërejnë që fushata deri tani është zhvilluar në mënyrë të qetë dhe të rregullt;
- Një tjetër karakteristikë e fushatës është që premtimet e partive politike i korrespondojnë më shumë zgjedhjeve parlamentare se sa atyre lokale duke u përqëndruar në premtime në nivel të politikave qendrore.
- Kjo fushatë është fokusuar më shumë tek kandidatët për kryetarë dhe duket se janë harruar që në këto zgjedhje qytetarët votojnë, gjithashtu, edhe për këshillin e bashkisë, dmth parlamentet lokale ku merren të gjitha vendimet e rëndësishme për zhvillimin e bashkisë dhe ku miratohen politika, programet e zhvillimit dhe buxhetet. Qytetarët, kanë fare pak informacion se kush janë kandidatët për këshilla bashkiakë, cilat janë CV-të e tyre dhe çfarë kontributi kanë dhënë për komunitetin e tyre.
- Gjatë këtyre zgjedhjeve, i është kushtuar kujdes i pamjaftueshëm komunitetit Rom dhe Egjyptian. Krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, ka një rritje në përdorimin e medias sociale dhe faqet e internetit nga kandidatët dhe partitë e tyre;
- Vëzhguesit e KZLNDQ raportojnë një numër të vogël rastesh ku partitë politike akuzohen të kenë ushtruar presion mbi administratën publike në nivel qendror dhe atë vendor, për t'u bërë pjesë e aktiviteve të fushatës zgjedhore.

Institucionet Publike dhe Përdorimi i Burimeve Publike në Fushatën Parazgjedhore

- Vëzhguesit e KZLNDQ-së pohojnë se ka disa raste ku ka dyshime se nga partitë politike është bërë presion mbi administratën, qendrore ose vendore, për t'u bërë pjesë e aktiviteteve elektorale gjatë fushatës.
- Vëzhguesit e KZLNDQ kanë marrë informacion nga bashkëbiseduesit në rreth pesë raste të supozuara të presionit mbi stafin e administratës publike, studentët ose të punësuarit të kompanive shtetërore që të marrin pjesë në mitingje dhe aktivitetet zgjedhore.

KZLNDQ pret nga Prokuroria të përfundojë sa më shpejt hetimet që kanë të bëjnë me rastet e transferimit të votuesve në Durrës dhe Kavajë. Nëse këto provohen të jenë të vërteta, do ta rrezikojnë seriozisht kredibilitetin e procesit zgjedhor në Shqipëri. KZLNDQ i bën thirrje Prokurorisë të hetojë rastet e përmendura më sipër dhe të ndëshkojë ata që kanë abuzuar.

KZLNDQ do të publikojë raportin e saj të ardhshëm të ndërmjetëm në lidhje me vëzhgimin e situatës parazgjedhore, më 19 qershor 2015.

2. Plani i vëzhgimit të zgjedhjeve lokale të 21 maj 2015

2.1 Plani i veprimit para ditës së zgjedhjeve

KZLNDQ do të angazhojë 90 vëzhgues të trajnuar, të pavarur për të gjitha 90-të Zonat e Administrimit Zgjedhor (ZAZ) për të vëzhguar përpara ditës së zgjedhjeve. Misioni i tyre fillon në datën 22 maj dhe përfundon me ditën e zgjedhjeve. Gjatë kësaj periudhe vëzhguesit do të monitorojnë punën e administratës elektorale, fushatën e kandidatëve të partive politike, kandidatët e pavarur, si dhe dhe përdorimin e mundshëm të fondeve publike apo abuzimin me zyrat publike për qëllime elektorale. KZLNDQ do të monitorojë nga afër zbatimin e kërkesave ligjore për listat e votuesve, përfaqësimi gjinor në administratën zgjedhore dhe në listat e kandidatëve, si dhe përgatitjet për të siguruar qasje për të gjithë popullatën në qendrat e votimit. Metodologjia e vëzhgimit afatgjatë të KZLNDQ-së është bazuar në standardet ndërkombëtare e cila jep paraqitjen e disa elementëve kryesorë të fushatës si dhe identifikimin dhe dokumentimin e problemeve, nëse ato ndodhin.

2.2 Plani i veprimit për ditën e zgjedhjeve

Ditën e zgjedhjeve, KZLNDQ, do të përdorë një metodologji statistikore në planin e saj të vëzhgimit. KZLNDQ ka përdorur të njëjtën metodologji në planin e vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare të viti 2013 për qarkun e Tiranës. Kjo metodologji, e njohur si vëzhgim i bazuar në statistika, është një mënyre shumë e mirë e që do ti japë mundësi KZLNDQ të vlerësojë me besueshmëri procesin e ditës së zgjedhjeve (hapjen, votimin, mbylljen e qendrave të votimit) për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Koalicioni do të shpërndajë 500 vëzhgues të palëvizshëm në një kampion të rastësishëm qendrash votimi në të gjithë Shqipërinë, dhe 500 vëzhgues të tjerë, të pozicionuar me të njëjtën metodologji statistikore, për të vëzhguar qendrat e votimit në bashkitë ku gara do të konsiderohet konkurruese. Vëzhguesit do të jenë të stacionuar gjatë gjithë ditës në qendrën e votimit që do tu caktohet, nga momenti i hapjes së qendrës së votimit deri në momentin e dorëzimit të materialeve të Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ).

Për arsye se numërimi i votave nuk bëhet në qendrat e votimit, KZLNDQ nuk do të parashikojë rezultate të zgjedhjeve. KZLNDQ nuk do të monitorojë transportin e fletëve të votimit nga Qendra e Votimit në qendrën e Numërimit të Votave. Por nga vëzhgimi,



KZLNDQ do të ketë informacione të sakta për cilesinë e procesit të ditës së zgjedhjeve dhe për pjesëmarrjen në votim.

Rezultate do të kenë nivel besueshmërie të lartë prej 95 përqind. Kjo shifër është e pranuar nga statisticienët ndërkombëtarë si e standarteve më të larta, duke i bërë përfundimet e KZLNDQ shumë të besueshme. Rezultatet që do të paraqiten nga KZLNDQ do të jenë brenda kufirit të pranuar të gabimit, i cili do të jetë midis 3 dhe 5 përqind.

2.3 Plan i Veprimit pas Ditës së Zgjedhjeve

Pas ditës së zgjedhjeve, KZLNDQ do të dërgojë vëzhgues në të gjitha qendrat e numërimit në të gjithë vendin, në mënyrë që të jetë në gjendje të analizojë procesin e numërimit. Vëzhguesit e KZLNDQ-së do të monitorojnë të gjithë procesin e numërimit, duke filluar nga marrja e materialeve nga KZAZ-ja deri në nxjerrjen e rezultateve. KZLNDQ nuk do të monitorojë procesin e transportimit të kutive të votimit nga qendra e votimit në qendrën e numërimit.

2.4 Komunikimi me publikun

Vëzhguesit e KZLNDQ-së do të trajnohen nga stafi i KZLNDQ-së për të vëzhguar periudhën para-zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve. Vëzhguesit do të përdorin një formë të standardizuar për të regjistruar vërejtjet e tyre, të cilat do të transmetohen më pas në qendrën e komunikimit të KZLNDQ -së në Tiranë. Çdo vëzhgim hidhet më tej në një bazë të dhënash, projektuar posaçërisht për këtë qëllim dhe që lejon KZLNDQ-në të mbledhë dhe të analizojë lehtësisht të dhënat. Pas analizimit të të dhënave, KZLNDQ-ja do të nxjerrë deklaratat gjatë gjithë periudhës para-zgjedhore, në ditën e zgjedhjeve dhe pas procesit të numërimit për të ndarë me publikun dhe aktorët e zgjedhjeve gjetjet e rëndësishme lidhur me cilësinë e procedurave zgjedhore dhe shkeljet e mundshme të tyre.

KZLNDQ-ja do të publikojë raporte bazuar në gjetjet e vëzhguesve të saj gjatë procesit para-zgjedhor, duke përfshirë edhe një raport paraprak para ditës së zgjedhjeve. Më 19 qershor 2015, KZLNDQ-ja do të organizojë një simulim të ditës së zgjedhjeve, në selinë e saj, për të testuar mekanizmat e mbledhjes dhe marrjes së të dhënave nga vëzhguesit. Dita e simulimit do të përfshijë të gjithë vëzhguesit që do të vendosen në ditën e zgjedhjeve mbi bazën e njëjësive kampionë në të gjithë Shqipërinë dhe operatorëve të komunikimit në selinë qendrore. KZLNDQ-ja do të publikojë, së paku, dy njoftime për shtyp në ditën e zgjedhjeve, ndërsa raporti i parë pas ditës së zgjedhjeve do të dalë më 22 qershor. Raporti përfundimtar do të dalë menjëherë pas publikimit zyrtar të rezultateve.

3. Situata politike

Zgjedhjet e 21 qershorit 2015 do të jenë zgjedhjet e para në Shqipëri, që kur Këshilli Evropian i BE-së i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian në qershor të vitit 2014. Mbajtja e zgjedhjeve që përmbushin standardet evropiane dhe ndërkombëtare, për të garantuar kushtet për votim të lirë e të ndershëm të qytetarëve, ka qenë një nga kushtet kryesore të Bashkimit Evropian për Shqipërinë.



Raporti i Progresit i Komisionit European 2014 deklaroi se *"Puna duhet ndërtuar mbi progresin në zgjedhjeve parlamentare të 2013, Shqipëria ka nevojë të zbatojë rekomandimet e misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve OSBE/ODIHR, për forcimin e sidomos pavarësinë e organeve të administratës zgjedhore, edhe përpara zgjedhjeve vendore të 2015."*

Zhvillimi i zgjedhjeve formaton jetën politike në afat të gjatë në vend, si dhe ndikon edhe rrugën e Shqipërisë drejt integritit në BE. Për këtë arsye, është e rëndësishme që zgjedhjet reflektojnë pjekurinë e klasës politike dhe qytetarëve në Shqipëri.

Këto do të jenë zgjedhjet e para lokale të kryera në kontekstin e zbatimit të reformës së re administrative dhe territoriale (RAT) - miratuar nga Parlamenti më 31 korrik 2014. Reforma e re territoriale administrative zvogëloi numrin e njësive administrative pa ndryshuar numrin e qarqeve në Shqipëri. Përsa i përket menaxherëve lokalë Reforma Administrative Territoriale do të sjellë reduktimin e numrit të Kryetarëve nga 373 në 61 dhe numrin e këshilltarëve bashkiakë nga 6152 në 1595. Çdo reformë për riorganizim territorial ka një ndikim në zgjedhje. Megjithatë, edhe pse opozita dhe disa nga partitë joparlamentare pohuan se procesi i reformës nuk ishte gjithëpërfshirës dhe se sipas tyre rindarja është bërë sipas interesave politike dhe nuk ka marrë parasysh specifikat e zonave të populluara nga minoritetet, të gjithë aktorët kanë zgjedhur të garojnë në zgjedhje.

Më datën 21 qershor 2015, sipas të dhënave nga Komisionin Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) 3,370, 2061 votues shqiptarë do të kenë mundësinë të shprehin vullnetin e tyre politik në 5299 qendra votimi për të zgjedhur kryetarët dhe këshillat e rinj bashkiakë, sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kjo fushatë është e karakterizuar nga angazhim i plotë dhe aktiv i liderëve të partive dhe nga zbatimi i platformave politike që janë më karakteristike për zgjedhjet parlamentare – sic është nxitja e rritjes ekonomike, ulja e papunësisë dhe e taksave, duke përfshirë edhe TVSH-në, investimet e mëdha publike, çmimi i energjisë elektrike, etj.

4. Legjislacioni dhe Administrimi i Zgjedhjeve

4.1 Kuadri Ligjor

Zgjedhjet për qeverisjen vendore të 21 Qershorit 2015 po kryhen në bazë të një kuadri ligjor të shëndoshë, bazuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Kodin Zgjedhor. Dispozitat e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor janë të mbështetura nga vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së. Legjislacioni i zgjedhjeve lokale ofrohet nga Kushtetuta, Kodi Zgjedhor dhe rregulloret e KQZ-së. Ndërsa legjislacioni shtesë përfshin Ligjin për Qeverisjen Vendore, Ligjin për Partitë Politike, Kodin e Procedurave Administrative dhe Kodin Penal. Shqipëria garanton të drejtën e votës për çdo qytetar (të personave mbi 18 vjeç). Qytetarët kanë të drejtë të barabartë vote: çdo votues ka një votë. Kjo e drejtë themelore është e garantuar nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe Kodit Zgjedhor.

¹ http://ëëë2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/QV/150529_-_DTI_-_QV_zgjedhes_lista.htm

Kodit Zgjedhor i miratuar në vitin 2012 ka pësuar disa ndryshime për këto zgjedhje për t'ju përshatur RAT. Ndryshimet janë kryesisht për çështjet e administratës zgjedhore, si ndarja e Zonave të Administrimit Zgjedhor, përmbajtja dhe formati i listave të zgjedhësve, e vendndodhja dhe përgatitja e qendrave të numërimit të votave. Janë bërë ndryshime domethënëse në nenin 67 në lidhje me përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve të partive dhe koalicioneve. Sipas ndryshimeve më të fundit në 2015, për zgjedhjen e organeve të pushtetit vendor, për çdo këshill bashkiak, lista shumemërore duhet të përmbajë 50% përfaqësim për seciën gjini dhe një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet ti përkasë së njëjtës gjini. Listat që nuk janë në përputhje me përfaqësimin gjinor nuk pranohen për regjistrim. Ky është konsideruar si një ndryshim i rëndësishëm i nenin 175, ku flitet për sanksionet në rastin e dështimit nga ana e subjektit zgjedhor të përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor u amendua për zgjedhjet lokale të 21 qershor 2015 në Parlament më 1 prill 2015. Miratimi shumë vonë i Kodit Zgjedhor, dy muaj para datës së fillimit të fushatës zgjedhore, është në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe krijoi një situatë të vështirë në vendimarrjen e KQZ-së.

4.2 Administrimi i Zgjedhjeve

Zgjedhjet në Shqipëri administrohen nga një administratë zgjedhore me tre nivele:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), i përbërë nga 7 anëtarë
- 90 Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) me 720 komisionerë.
- 5299 Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV).

Përveç këtyre do të ketë 90 Qendra të Numërimit të Votave (VNV), një për çdo zonë të administrimit zgjedhore (ZAZ), ku grupet e numërimit (GN) numërojnë votat në nivel ZAZ-je.

KQZ-ja është një organ i përhershëm, përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Përgjegjësitë e KQZ-së përfshijnë krijimin e ZAZ-ve, emërimin dhe largimin e anëtarëve të KZAZ-ve, shtypjen e fletëve të votimit, trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë të nivelit më të ulët, mbikëqyrjen e financave të fushatës, vendosjen e sanksioneve për kundërvajtjet administrative në lidhje me zgjedhjet, duke marrë parasysh ankesat dhe apeli, dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare për këshillat vendorë .

KZAZ-të emërohen nga KQZ-ja për çdo zgjedhje dhe janë të përbërë nga shtatë anëtarë dhe një sekretar, pa të drejtë vote. Anëtarët e KZAZ-ve propozohen nga partitë. Edhe pse KZAZ-të duhej të krijoheshin që më 13 prill 2015 dhe trajnimi i tyre duhej të bëhej para fillimit të punës, anëtarët e KZAZ-ve janë ndryshuar shumë herë për një periudhë të shkurtër para zgjedhjeve. Janë emëruar anëtarë të rinj të patrajnuar. Për të përgatitur anëtarët e emëruar rishtazi të KZAZ-ve, KQZ-ja kreu një sesion trajnimi më 3 qershor për të trajnuar komisionerët e rinj dhe rifreskimin e njohurive të të tjerëve. Megjithatë, ende KQZ-ja merr kërkesa për ndryshimin e komisionerëve. Këto ndryshime kanë ndikuar seriozisht në përgjegjësitë e KZAZ-ve për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ-në nën

mbikëqyrjen e tyre, të tilla si emërimi i anëtarëve të KQV-ve dhe GN-ve, shpërndarja e materialeve tek KQV-të dhe nxjerrjen e rezultatit në nivel lokal.

KQV-të përbëhen nga shtatë anëtarë dhe emërohen nga KZAZ-të, bazuar në listat e partive. E njëjta formulë për krijimin e KZAZ-ve është rruajtur edhe këtu. Partitë politike propozojnë anëtarët e KQV-ve (*KQV-të duhet të krijohen jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve*). KQV-të janë përgjegjëse për organizimin e votimit, si dhe paketimin dhe transportimin e fletëvotimeve dhe materialeve tjera zgjedhore, pas votimit, për në VNV-të përkatëse. Në Shqipëri është i garantuar votimi i përgjithshme dhe i barabartë për qytetarët e rritur si dhe respektimi që çdo votues ka, në parim, të drejtën e një vote. Kjo e drejtë themelore është e garantuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në Kodin Zgjedhor. Çdo VNV ka ndërmjet 3 dhe 10 tavolina numërimi, secila me dy GN-vë që punojnë në ndërrime. Çdo tavoline numërimi ka katër anëtarë, dy nga shumica dhe dy nga opozita dhe ato duhet të krijohen brenda datës 11 qershor. Me përjashtim të Kryetarit të KQZ-së, të gjithë anëtarët, në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore, janë emëruar politikisht, pra duke e vënë procesin në mëshirën e vullnetit të palëve. Sipas afateve të përcaktuara, qartësisht, fushata ka filluar më 22 maj dhe do të përfundojë më 19 qershor me një ditë heshtje zgjedhore më 20 qershor, një ditë para ditës së zgjedhjeve.

4.3 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është autoriteti më i lartë shtetëror që administron zgjedhjet lokale dhe parlamentare. KQZ përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët zgjidhen nga Parlamenti i Shqipërisë në bazë të propozimeve të partive politike, me një kryetar KQZ me kandidim të pavarur. Anëtarët e KQZ-së duhet të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur. Pasi emërohen, komisionerët bëhen mbrojtësit e procesit zgjedhor dhe interesave të qytetarëve, dhe jo të interesave të partive të tyre.

Vendimet më të rëndësishme të KQZ-së lidhur me ndarjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor, llogaritjen e rezultateve të zgjedhjeve, shpërndarjen e mandateve, pavlefshmërinë e zgjedhjeve, kërkojnë një shumicë të cilësuar të votave. Pjesa tjetër e vendimeve të KQZ-së kërkojnë shumicë të thjeshtë votash; vendime të tilla përfshijnë regjistrimin e kandidatitve, emërimin/zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-ve dhe monitorimin e punës së tyre të përditshme, trajnimin e anëtarëve të KZAZ-ve në periudhën para-zgjedhore, vendosjen e sanksioneve administrative për shkeljen e Kodit Zgjedhor, etj.

Për Zgjedhjet e Qeverisjes Lokale që po afrojnë, KQZ-ja ka rritur publicitetin e mbledhjeve duke dërguar njoftime të rregullta dhe në kohë. Mbledhjet u njoftuan nëpërmjet postës elektronike dhe ose përmes mjeteve të tjera të publikimit, ndaj dhe deri tani të gjithë pjesëmarrësit, përfaqësuesit e partive politike, media dhe vëzhguesit janë njoftuar paraprakisht lidhur me mbledhjet e ardhshme. Rendi i ditës publikohet paraprakisht në faqen zyrtare të KQZ-së si dhe nga zëdhënësja e KQZ-së. Mbledhjet e KQZ-së janë zhvilluar në orar, dhe kanë lejuar edhe praninë e medias dhe palëve të tjera të interesuara. Të gjitha mbledhjet e KQZ-së janë transmetuar drejtpërdrejt në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, prandaj, të gjitha palët e interesuara dhe/ose aktorët mund të kenë akses të plotë dhe në kohë reale në vendimmarrjen dhe diskutimet e KQZ-së.

KQZ-ja ka zhvilluar diskutime mbi çdo çështje të paraqitur në rendin e ditës dhe i ka dhënë të drejtën përfaqësuesve të partive politike të paraqesin vërejtjet e tyre përpara marrjes së vendimeve.

Udhëzimet e KQZ-së janë miratuar në mënyrë unanime lidhur me procedurat për marrjen e Kutive të Votimit nga grupet përkatëse, shpërndarjen e Grupeve të Numërimit, përbërjen e tyre si dhe procedurat për numërimin, për krijimin dhe funksioneve e KQV-ve, si dhe Udhëzimet mbi grumbullimin e të dhënave dhe rezultatet paraprake të zgjedhjeve². Gjithashtu, u miratuan unanimisht vendimet e KQZ-së No. 588, i datës 28 maj 2015 mbi miratimin e përdorimit e mjetit të posaçëm që i mundëson personat e verbër të lexojnë Fletën e Votimit dhe vendimi No. 578, i datës 26 maj 2015 për miratimin e Manualit të Grupit të Numërimit .

Disa vendime të KQZ-së (më poshtë) u morën me shumicë të thjeshtë, me miratimin e vetëm 4 anëtarëve të KQZ-së:

- Vendimi i KQZ-së i datës 1 qershor 2015, për të shqyrtuar vendimin e Kolegjit Zgjedhor për dorëheqjen e kandidatit për Bashkinë e Kurbinit Z. Altin Biba dhe miratimin e kandidatit tjetër z. Ilir Pjetraj - [*KQZ vendosi të mos pranojë dorëheqjen e z. Biba dhe shfuqizojë vendimin e KZAZ-së për emërimin e kandidatit tjetër z, Pjetraj. Në këto rrethana, z Biba do të kandidojë zyrtarisht për Bashkinë e Kurbinit]*
- Vendimi i KQZ-së i datës 1 qershor 2015, mbi vlerësimin e raportit të Bordit të Monitorimit të Zgjedhjeve / BMZ mbi fushatën elektorale për të kompensuar kohën për partitë politike, duke refuzuar propozimin e BMZ-së për vendosjen e gjobave për kompanitë e medias.
- Vendimi i KQZ-së i datës 2 qershor 2015 mbi partitë politike që kanë të drejtë për të marrë pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarit të tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit; KQZ-ja vendosi që anëtari i tretë duhet të jetë nga LSI-ja dhe anëtari i katërt nga PR-ja / Partia Republikane, për këtë arsye PDIU-ja u la jashtë shortit për anëtarët e Grupit të Numërimit.

Informacioni mbi votimin e anëtarëve të KQZ-së është evidentuar nga monitorimi i mbledhjeve të KQZ-së dhe nga media; por ky informacion nuk është ende në dispozicion në faqen zyrtare të KQZ-së. Kjo është diçka që KQZ-ja mund të marrë në konsideratë si pikë për përmirësim sa i përket publicitetit dhe transparencës së veprimtarisë së saj.

Në të gjitha vendimet e KQZ-së të publikuara në internet deri tani, asnjëri prej tyre nuk është versioni origjinal i skanuar me nënshkrimet e anëtarëve të KQZ-së; kjo krijon vështirësi për publikun dhe aktorët e interesuar për t'u njohur me kuorumin e anëtarëve të KQZ-së që kanë vendimin.

² Të gjitha vendimet e KQZ gjenden të publikuara online në faqen e saj të internetit <http://ëëë2.cec.org.al/sq-al/Udh%C3%ABzime-2015>.

4.4 Kolegji zgjedhor

Subjektet zgjedhore kanë të drejtën të ankimojnë vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve pranë Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditë nga shpallja e vendimit, ose pas mosmarrjes së një vendimi nga KQZ. Kolegji Zgjedhor përbëhet nga 8 Gjyqtarë të Gjykatës së Apelit të përzgjedhur³ me short. Kolegji është formuar në Zgjedhjet e kaluara Parlamentare të vitit 2013 dhe funksionon edhe për Zgjedhjet e ardhshme lokale të 21 Qershorit 2015. Vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë përfundimtare.

KZLNQ ka monitoruar aktivitetin e Kolegjit Zgjedhor përmes mbulimit që media i ka bërë veprimtarisë së tij dhe publikimeve online të vendimeve.

Deri tani, Kolegji ka gjykuar 18 ankime ndaj vendimeve të KQZ. Në periudhën parazgjedhore, krahasuar me ciklet e kaluara zgjedhore, ka pasur një rritje të numrit të ankimeve⁴ për çështjet parazgjedhore, veçanërisht të ankimeve që lidhen me regjistrimin e kandidatëve. Kolegji Zgjedhor ka gjykuar çështjet brenda afateve ligjore⁵.

Në përmbushjen e detyrave të tyre, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor varen nga hapësirat, personeli dhe logjistika në që Gjykata e Apelit Tiranë⁶ u ka vënë në dispozicion; sekretaret e Kolegjit Zgjedhor nuk janë trajnuar paraprakisht mbi procedurat zgjedhore dhe nuk kanë asistentë ligjorë në ndihmë të veprimtarisë së gjyqtarëve të Kolegjit.

Proceset gjyqësore të zhvilluara nga Kolegji Zgjedhor kanë qenë publike, në prezencë të medias, dhe palët janë njoftuar sipas ligjit. Megjithatë, ndryshe nga mbledhjet e KQZ, seancat e Kolegjit Zgjedhor nuk transmetohen online ndonëse vendimet e tij janë përfundimtare dhe mbyllin përfundimisht ciklin e ankimeve zgjedhore.

Deri tani, 12 vendime⁷ (nga 18 vendime të gjykuara) janë të publikuara⁸ në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë, megjithëse jo menjëherë pas dhënies së vendimit nga gjyqtarët. Vendimi mbi çregjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet në Bashkinë Kurbin nuk është publikuar ende online, megjithëse vendimi është zbardhur dhe ka qarkulluar ndërkohë një kopje e skanuar e tij.

³ Nga i gjithë vendi, përzgjedhur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

⁴ Gjatë kohës që shërbejnë si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor, gjyqtarët gjithashtu vazhdojnë të merren me angazhimet e zakonshme në gjykatën përkatëse duke qenë se gjykojnë çështje jo-zgjedhore në panele me 3 gjyqtarë dhe koordinimi i shtyrjes së gjyqeve është i vështirë; në këto kushte, rritet ngarkesa e punës së tyre.

⁵ 10 ditë nga paraqitja e ankimit

⁶ Kolegji Zgjedhor akomodohet nga Gjykata e Apelit e Tiranës, e cila duhet të ofrojë hapësirë pune, materiale dhe personel të mjaftueshëm për të bërë të mundur përmbushjen e detyrave.

⁷ Nga 12 vendimet e publikuara online në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezultojnë:

- 1 vendim lidhur me kërkesat për referendum për reformën administrative; vendimi i KZ shfuqizoi vendimin e KQZ;
- 2 ankime u dërguan për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë,
- 1 vendim ku Kolegji Zgjedhor e pushoi çështjen
- 3 vendime të Kolegjit shfuqizuan vendimet e KQZ
- 3 vendime të Kolegjit lanë në fuqi vendimet e KQZ
- për 2 ankime çështja u pushua pjesërisht dhe Kolegji kërkoi marrjen e një vendimi nga KQZ

⁸ <http://eëë.gjykataeapelitirane.al/?fq=brenda&m=shfaqart&aid=91>

5. Analizë e periudhës dy-javore dhe gjetjet

5.1 Aktiviteti i KZAZ-ve

5.1.1 Aktiviteti i KZAZ-ve

Nëntëdhjetë (90) Vëzhgues Afatgjatë të KZLNDQ kanë vëzhguar aktivitetin e KZAZ-ve gjatë periudhës 22 Maj-6 Qershor. Ata kanë marrë pjesë në 283 mbledhje nga 404 të zhvilluara gjithsej, përfshi trajnimet e dt. 2-4 Qershor të kryera nga KQZ-ja. Numri relativisht i ulët i mbledhjeve në total i detyrohet faktit që një pjesë të mirë periudhës KZAZ-të e kanë shpenzuar në terren duke inspektuar infrastrukturën e qendrave të votimit dhe afishimin e listave të zgjedhësve në to, por ndërkohë një numër KZAZ-ësh po tregohen të ngadalta në kryerjen e detyrave, kjo për arsye teknike të sqaruara më poshtë dhe për mungesë bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes komisionerëve.

5.1.2 Proceduraliteti dhe vendimmarrja

Mbledhjet e KZAZ-ve janë zhvilluar përgjithësisht në një atmosferë të qetë dhe pa probleme të mëdha. Megjithatë, VAGJ-të e KZLNDQ kanë vënë re mosrespektimin e protokolleve për mbarëvajtjen e mbledhjeve.

Në pothuajse të gjitha KZAZ-të nuk respektohen oraret⁹ për ushtrimin e aktivitetit të komisionit. Përkundrazi, nga intervistat e kryera me anëtarët e komisioneve, në 25 KZAZ është praktikë e zakonshme që një numër mbledhjesh të kryhen me anë të telefonatave mes komisionerëve apo në ambiente jashtë KZAZ-se.¹⁰ Kjo vjen, mes të tjerash, si pasojë e mbingarkesës me të cilën përballen komisionerët, të cilët kanë punë të rregullta ditore dhe nuk e kanë të lehtë të mbulojnë të dyja detyrat paralelisht.

Njëkohësisht, 25 KZAZ nuk angazhohen të njoftojnë publikisht mbledhjet e radhës, axhendat përkatëse, por edhe në publikimin e vendimmarrjes që kryhet.¹¹ Megjithëse Kodi Zgjedhor dikton se mbledhjet e KZAZ-se janë publike¹², në disa KZAZ nuk janë lejuar të marrin pjesë vizitorë që kanë synuar të ndiqnin mbledhjet e KZAZ-së pa një akreditim nga ana e KQZ-së, përfshi vëzhguesit e KZLNDQ¹³.

Në sajë të ndërrimeve të shpeshta që i kanë paraprirë dt. 22 Maj, por edhe ndërrimeve pas kësaj date¹⁴, KZLNDQ vëren me shqetësim se kemi një numër të konsiderueshëm

⁹ Udhëzimi nr. 2 i KQZ-së, dt. 25.2.2009, Neni 18/1 përcakton se: “Gjatë periudhës zgjedhore dhe deri tre ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-ja punon paradite nga ora 08:00 – 13:00 dhe mbasdite 16:00 – 20:00.”

¹⁰ Po aty, Neni 20/1 përcakton se: “Mbledhjet e KZAZ-së janë publike. Ato zhvillohen vetëm në ambientet e saj të punës.”

¹¹ Po aty, Neni 22/6 përcakton se: “KZAZ është e detyruar që të bëjë menjëherë publike vendimet e marra...”

¹² Kodi Zgjedhor, Neni 35/1: “Mbledhjet e KZAZ-së janë publike”

¹³ Në 5 KZAZ vëzhguesve të KZLNDQ iu mohua hyrja kur këta të fundit ishin ende të pa akredituar. Vetëm pasi vëzhguesit cituan Kodin Zgjedhor mbi faktin që mbledhjet e KZAZ-se janë publike, ata u lejuan të marrin pjesë si publik.

¹⁴ Në prill janë kryer 44 zëvendësime në nivel KZAZ-je dhe 85 zëvendësime në maj. Në qershor vazhdojnë ndërrimet me një ritëm të lartë. Që nga fillimi zyrtar i fushatës në 22 maj, vëzhguesit e KZLNDQ kanë numëruar 19 raste ku komisionerët janë ndërruar ose në proces ndërrimi.

komisionerësh pa përvojë¹⁵, pavarësisht faktit se pothuajse të gjithë i janë nënshtruar trajnimit të KQZ-së.¹⁶ Këtu është e rëndësishme të përmendim faktin se KQZ-ja u ka bërë disa herë thirrje partive të ndalojnë me ndërrimin e komisionerëve, por realiteti tregon se këto thirrje kanë rënë në vesh të shurdhët.

5.1.3 Selitë e KZAZ-ve, infrastruktura, logjistika dhe burimet në dispozicion të KZAZ-ve

Pavarësisht se Kodi Zgjedhor e përcakton qartë se selitë e KZAZ-ve nuk mund të krijohen në godina në përdorim nga administrata publike¹⁷, me përjashtim të institucioneve kulturore, arsimore dhe shëndetësore, vazhdojmë të kemi 11 KZAZ (shih tabelën më poshtë), selitë e të cilave ndodhen në godina në përdorim të administratës vendore dhe/ose qendrore. Ndërkohë, KZAZ 86 (Bashkia Himarë) po punon ende në një ambient provizor (godinë kopshti) dhe do të transferohet në zyrat përfundimtare (ambientet e stadiumit të futbollit) në datën 12.06.2015.

KZAZ	Adresa
1	Drejtoria e Bujqësisë, KOPLIK
9	Salla e Mbledhjeve, Bashkia Bajram Curri, TROPOJË
20	Salla e Aktiviteteve, Bashkia Krujë, KRUIJË
52	Bashkia LIBRAZHD
71, 72	Salla e Aktiviteteve, Bashkia Korçë, KORÇË
74	Salla e Aktiviteteve, Nënprefektura, PËRMET
75	Salla e Këshillit Bashkiak, KËLCYRË
76	Salla e Mbledhjeve, Bashkia Memaliaj, MEMALIAJ
77	Nënprefektura, Godina e Bashkisë, TEPELENË
88	Salla e Aktiviteteve, Këshilli Bashkiak, SARANDË

Janë të shumta KZAZ-të që hasin probleme në lidhje me infrastrukturën, logjistikën, bashkëpunimin me institucione të tjera (KQZ, njësitë vendore). Në total kemi 26 KZAZ të cilat vuajnë nga mungesa e infrastrukturës dhe/ose logjistikës. Nga këto, nëntëmbëdhjetë (19¹⁸) KZAZ kanë deklaruar se selia ndodhet në ambiente të papërshtatshme dhe jofunksionale, me mungesë hapësire, elektriciteti dhe furnizimi me ujë; këto KZAZ deklarojnë gjithashtu se kanë mungesë në logjistikë (mungojnë lidhjet telefonike dhe interneti, kompjuter, printer dhe faks). Njëmbëdhjetë (11¹⁹) KZAZ janë shprehur të pakënaqura nga bashkëpunimi me KQZ-në²⁰ dhe shtatë (7²¹) KZAZ janë shprehur të

¹⁵ Përvoja nuk është e kërkuar nga ligji, por, pavarësisht përgatitjes teorike që vjen nga trajnimi, KZLNDOQ është e mendimit se çdo komisioner ka nevojë për kohë dhe për praktikë të punojë siç e kërkon detyra. Rrjedhimisht, sa më shpesh të ndërrohen komisionerët dhe sa më pranë ditës së zgjedhjeve, aq më shumë rritet probabiliteti që komisionerët e rinj të mos jenë në gjendje të përmbushin detyrat.

¹⁶ Si shembull, në dt. 03.06.15, me Vendimin 615 të KQZ-së kemi 2 zëvendësime të reja në KZAZ 44 (Bashkia Peqin), ndërkohë që KQZ ka kryer trajnimin e fundit me komisionerët e ZAZ-ve gjatë datave 2-4 qershor 2015. Një sërë kërkesash të tjera, si p.sh. kërkesa e KZAZ 1 (Bashkia Koplík) për ndërrimin e kryetarit dhe kërkesa e KZAZ 2 (Bashkia Shkodër) për ndërrimin e tre anëtarëve, janë ende në pritje të shqyrtimit nga KQZ-ja

¹⁷ Kodi Zgjedhor, Neni 93/2/b përcakton se: "...selitë e KZAZ-ve...nuk mund të krijohen në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore."

¹⁸ KZAZ 1, 4, 6, 13, 21, 30, 38-39, 48-49, 52-53, 57, 63, 66, 71, 83, 86, 89. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

¹⁹ KZAZ 5, 13, 22, 30, 34, 39, 47, 63, 66, 83, 89. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

²⁰ KZAZ-të në fjalë i janë drejtuar KQZ-së për zgjidhjen e këtyre problemeve, por në disa raste nuk kanë gjetur përgjigje.

²¹ KZAZ 2, 13, 34, 38, 52, 57, 83. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

pakënaqura me asistencën e marrë nga autoritetet lokale²² për zgjidhjen e këtyre problematikave. Vetëm katër (4²³) KZAZ janë shprehur të pakënaqura me mungesën e bashkëpunimit midis komisionerëve.²⁴

Puna e komisionerëve bëhet edhe më sfiduese nëse shikojmë bazën materiale dhe buxhetin që KZAZ-të kanë, ose më saktë nuk kanë në dispozicion për të kryer aktivitetin e tyre. Tridhjetë (30²⁵) KZAZ kanë probleme me bazën materiale (modularë, letra, bojëra, karburant), njëzetë e gjashtë (26²⁶) KZAZ nuk e kanë marrë ende buxhetin²⁷ e nevojshëm për të mbuluar shpenzimet e aktivitetit dhe pesë (5²⁸) KZAZ shprehen të pakënaqura me aftësitë e kolegëve për të kryer punën²⁹. Në total janë mbi gjysma e KZAZ-ve, 46 të tilla, të cilat kanë të paktën një mangësi në bazë materiale ose buxhet ose aftësi profesionale. Në shumicën e rasteve të sipërpërmendura, komisionerët mundohen t'i mbulojnë mangësitë në bazë materiale dhe buxhet nëpërmjet financave dhe burimeve në materiale vetjake. Është e kuptueshme, aq sa dhe e papranueshme, që këto vështirësi teknike të ndikojnë në performancën e komisionerëve.

5.1.4 Tabelë e KZAZ-ve me problematika të ndara në dy grupime

Problematika në infrastrukture, logjistike dhe bashkëpunim	Numri i KZAZ-ve	Problematika në baze materiale, buxhet dhe kapacitete profesionale	Numri i KZAZ-ve
Infrastruktura e papërshtatshme/Mungesa e logjistikës	19	Mungesa e Bazës Materiale	30
Mungesa e bashkëpunimit nga KQZ	11	Mungesa e Buxhetit	26
Mungesa e bashkëpunimit nga autoritetet lokale	7	Mungesa e Kapaciteteve Profesionale	5
Mungesë bashkëpunimi mes komisionerëve	4	Të Tjera	0
KZAZ-të me të paktën një problematikë të listuar sipër	26	KZAZ-të me të paktën një problematikë të listuar sipër	46

²² Sidomos për zgjidhjen e përkohshme të mungesave logjistike.

²³ KZAZ 20, 39, 44, 47. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

²⁴ Komisionerët akuzojnë njëri tjetrin se po urdhërohen nga partitë të zvarrisin punën.

²⁵ KZAZ 2, 4, 13, 16, 19, 21-23, 28-30, 33, 38-39, 42, 52-53, 57, 60-63, 66-67, 70-72, 83-84, 90. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

²⁶ KZAZ 2, 12-13, 19, 21-22, 29-30, 33, 38-39, 42, 46, 52-53, 62-67, 70, 72, 82, 89-90. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

²⁷ Pas konstatimit të kësaj problematike, KZLNDQ mori një sqarim nga KQZ se buxheti për KZAZ-të është lëvruar në dt. 04.06.2015.

²⁸ KZAZ 12, 39, 47-49. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

²⁹ Aftësia për të kuptuar ligjin dhe ndjekur procedurat.

6 Përfaqësimi gjinor në Komisionet e ZAZ-ve

KZLNQ vlerëson faktin që Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD) kanë respektuar kuotën gjinore të kërkuar nga ligji për përfaqësimin gjinor në komisione me jo më pak se 30%³⁰, kjo pavarësisht ndërrimeve të shpeshta të komisionerëve para dhe pas dt. 22 Maj. Deri në dt. 6 qershor, nga 270 komisionerë të PS, 103 (38%) janë femra; nga 270 komisionerë të PD, 87 (32%) janë femra.

Gjithsesi, edhe pse dy partitë e kanë respektuar ligjin, përfaqësimi gjinor në komisionet e ZAZ-ve ngelet larg frymës së ligjit, me vetëm 208 (29%) komisionere femra nga 720 komisionerë në total, duke përfshirë sekretarët. Këtu ndikon edhe numri i vogël i komisionereve femra i dy partive më të vogla, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partia Republikane (PR), të cilat kanë respektivisht vetëm 9 (10%) komisionere femra nga 90 komisionerë në total (për parti).

Nëse vërejmë përfaqësimin gjinor përsa u përket pozicioneve kyçe/drejtuese në komisione (kryetar, zv. kryetar dhe sekretar), atëherë shifrat bëhen edhe më dekurajuese. Nga 90 komisionerë për çdo pozicion të sipërpërmendur, kemi vetëm 14 (16%) kryetare komisionesh, 19 (21%) zv. kryetare dhe 22 (24%) sekretare.

5.1.5 Krijimi i Komisioneve të Qendrave të Votimit

Afati i fundit për krijimin e Komisioneve për Qendrat e Votimit (KQV) ishte 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Tridhjetë e gjashtë KZAZ nuk e respektuan afatin për disa arsye dhe pritjet që dy KZAZ³¹ ta përfundojnë procesin brenda dt. 09.06.2015.

Së pari, në njëzetë e tetë (28³²) KZAZ partitë vonuan dorëzimin e listave me kandidatë për komisionerë; pati mangësi në dokumentacionin e listave të dorëzuara; ose u pa nevojshme të zëvendësoheshin një sërë kandidatësh për komisionerë, të cilët nuk përmbushnin kriteret.

Së dyti, në njëmbëdhjetë (11³³) KZAZ u shkel afati për krijimin e komisioneve në sajë të problematikave të ndryshme, që këto KZAZ kanë me një numër qendrash votimi (QV në ambiente jofunksionale, në ambiente private, apo në adresa të gabuara).

Së treti, në njëmbëdhjetë (11³⁴) KZAZ puna për krijimin e komisioneve për QV-të u vonua nga vetë komisionet e ZAZ-ve, më së shumti për arsye mbledhje me vonesë, ndërkohë që KZAZ 1 (Bashkia Kopluk) është ende në pritje të ndërrimit të kryetarit të komisionit.

5.2 Fushata zgjedhore

Fushata për zgjedhjet vendore të 21 qershorit nisi zyrtarisht në 22 maj, por mund të thuhet se pothuajse të gjithë kandidatët dhe forcat politike e nisën fushatën javë përpara pikënisjes

³⁰ Kodi Zgjedhor, Neni 29/1/ç përcakton se: "30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini.

³¹ KZAZ 41 (Tiranë) dhe KZAZ 86 (Himarë).

³² KZAZ 1-2, 4-5, 9-10, 16, 18-19, 25, 31, 34-35, 39-41, 45-46, 48-49, 63-65, 71, 73, 81, 86, 90. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

³³ KZAZ 2, 4, 15, 34, 38-39, 49, 62, 71, 82, 85. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

³⁴ KZAZ 1, 9, 19-20, 23, 31, 34, 39-40, 46, 81. Shih listën e vendndodhjeve të KZAZ-ve në Aneksin

zyrtare. Megjithëse pas zgjedhjeve mund të ketë vend për diskutimin nëse koha në dispozicion për fushatë është në linjë me standardet ndërkombëtare në këtë drejtim, subjektet zgjedhore nuk duhet të shkelin legjislacionin zgjedhor vendas sa i përket këtyre afateve.

Ballafaqimi kryesor anembanë vendit është midis kandidatëve të Partisë Socialiste (PS) dhe Lëvizjes për Integrim (LSI), dy partitë më të mëdha në pushtet dhe pjesë e Aleancës për Shqipërinë Evropiane (ASHE), dhe kandidatëve të Partisë Demokratike (PD), partia më e madhe e opozitës dhe partia kryesore e Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD). Ndërkohë në garë janë edhe 15 kandidatë të pavarur (kandidatë të propozuar nga zgjedhësit) anembanë vendit.

Dy javë para zgjedhjeve, fushata vazhdon e qetë, pavarësisht intensitetit në rritje të garës. KZLNDQ vlerëson faktin që shumica e kandidatëve po i fokusojnë fushatat përkatëse rreth një platforme për zhvillimin e bashkive ku ata garojnë. Megjithatë, një pjesë e mirë e këtyre platformave nuk duket se mbështeten në plane të detajuara, të shoqëruara me vlerësime financiare dhe afate kohore, të cilat do të informonin sadopak qytetarët mbi mundësinë e përmbushjes së premtimeve zgjedhore.

Përfshirja në fushatë e kryetarëve të dy partive më të mëdha në vend ngelet problematike. Në dallim nga fryma dhe qëllimi i zgjedhjeve, kryetarët përkatës të PS dhe PD po kryejnë një fushatë në terma parlamentare: duke u fokusuar në mesazhe për ulje taksash në nivel kombëtar, për uljen e çmimit të energjisë, për ulje të çmimeve të shportës së konsumit, dhe për punësime në projekte madhore me karakter kombëtar, të cilat janë njëkohësisht kundërproduktive dhe keqinformuese për votuesit. Ata po rrezikojnë të polarizojnë në mënyrë të panevojshme garat zgjedhore mes kandidatëve vendorë.

Kandidatët kanë vijuar të përdorin format tradicionale të komunikimit të kandidatëve me zgjedhësit. Nga gjetjet tona ato mund të rreshtohen sipas dendësisë së përdorimit: postera, mitingjet, takimet derë më derë dhe duke përfunduar me debatet radio/televizive të kandidatëve. Përdorimi i rrjeteve sociale përbën një medium të preferuar për 81% të kandidatëve. KZLNDQ vlerëson kandidatët për praktikimin e gjerë të të ashtuquajturave dëgjesa publike apo takime diskutimi/debati me grupe qytetarësh dhe grupe të ndryshme interesi.

Vëzhguesit e KZLNDQ kanë monitoruar mesazhet dhe gjuhën e përdorur nga konkurrentët në garë dhe vëmë re me kënaqësi se kandidatët janë më shumë të fokusuar në platformat vetjake se sa në sulmet personale, edhe pse këto të fundit nuk mungojnë. Vëzhguesit afatgjatë nuk raportojnë për materiale denigruese apo anonime kundër kandidatëve.

Kandidatët për këshillat bashkiakë - në të vërtetë parlamentet lokale ku merren vendimet më të rëndësishme për zhvillimin e bashkive përkatëse – mungojnë në këtë garë zgjedhore. Për fat të keq, kandidatët për këshillat bashkiakë janë pjesë e sistemit proporcional me lista të mbyllura dhe informacioni i qytetarëve mbi këta persona, kualifikimet dhe kontributin e tyre të shkuar dhe atij të pritshëm në komunitetet përkatëse ngelet minimal. Në përgjithësi, kandidatët e këshillave bashkiakë nuk shihen të shoqërojnë kryetarët e bashkisë në takimet publike.

Është për t'u vlerësuar fakti që në këshillat bashkiake që do të dalin pas zgjedhjeve të 21 qershorit, pothuajse 50 përqind e këshilltarëve do të jene gra. Megjithatë, gratë mbeten të nënperfaqësuar kur vjen puna te kandidatët për kryetarë bashkie, me vetëm 16 (10%) kandidatë femra nga 161 kandidatë gjithsej. Pozitiv është fakti që për herë të parë në historinë e zgjedhjeve vendore, gratë garojnë për bashki të mëdha e konkurruese si Durrësi dhe Shkodra.

Një tjetër problematikë në këto zgjedhje mbetet përfaqësimi i komunitetit Rom dhe Egjyptian. Pavarësisht prezencës së konsiderueshme të këtij komuniteti në disa nga bashkitë më të mëdha në vend, është e vështirë të gjesh pjesëtarë të këtij komuniteti në listat e partive për kandidatë në këshillat bashkiake, por edhe premtime që trajtojnë problemet dhe nevojat e tyre të përditshme. Nuk raportohet nga vëzhguesit tanë ndonjë aktivitet elektoral të kandidatëve për kryetar bashkie në zonat ku banon ky komunitet dhe ata vazhdojnë të mbeten jashtë fokusit të platformave zgjedhore të prezantuara nga kandidatet.

Ka një plan të detajuar masash nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale të Policisë së Shtetit. Është zhvilluar trajnimi i forcave në terren mbi tematike të tilla: si të sillen gjatë fushatës dhe si të trajtohen rastet e shkeljes së ligjit gjatë procesit zgjedhor.³⁵ Derimëtan, përveç një incidenti në Vaun e Dejës, në ditën e hapjes zyrtare të fushatës, forcatbe policisë nuk janë përfshirë në incidente në lidhje me zgjedhjet dhe KZLNDQ i inkurajon forcat policore që të vazhdojnë këtë sjellje korrekte.

Megjithëse jo një fokus specifik i monitorimit të KZLNDQ, vëzhguesit tanë afatgjatë, pas bisedave me shtabet elektorale në të gjithë vendin, nuk raportojnë shqetësime mbi pasqyrimin e fushatës zgjedhore në mediat kombëtare kur flitet për dy koalicionet kryesore në garë. Nga ana tjetër, kandidatët e pavarur³⁶ nuk po gëzojnë akses të mjaftueshëm në mediat kombëtare. Kjo e bën fushatën e tyre të pabarabartë me konkurrentët partiakë, por nga ana tjetër ndikon edhe tek votuesi i cili nuk merr të gjithë informacionin e duhur për kandidatët e pavarur, duke cunguar, tërthorazi, vendimin e tij për votën e hedhur.

I gjithë aktiviteti zgjedhor i deritashëm sugjeron që kjo është një fushatë e shtrenjtë për sa u përket kandidatëve të tre partive të mëdha. Rasti më tipik është mbulimi i qytetit të Shkodrës me flamuj të të dy kandidatëve kryesore, vetëm që të hiqeshin përsëri një javë më vonë, pas reagimit jo të favorshëm nga ana e qytetarëve. Vetëm një kandidat i pavarur ka zbardhur kontributet financiare nga donatorët e tij dhe ka ftuar partitë të bëjnë të veprojnë njësoj. KZLNDQ vlerëson aktin në fjalë dhe fton të gjithë kandidatët dhe partitë të zbardhin të dhënat financiare dhe kontributet nga donatorët dhe të tregohen sa më proaktivë në raportimin e tyre, duke pasqyruar mësëmiri përgjegjësinë politike përpara votuesve.

³⁵ Forcat e police ka kryer nje trajnim të drejtuar nga Prezenca e OSBE-së ne muajin Mars dhe nje sere trajnimesh te tjera 20.04-05.05.2015: https://ëëë.facebook.com/permalink.php?story_fbid=1605689033050795&id=1502420603377639

³⁶ Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, z. Gjergj Bojaxhi (Bashkia Tiranë) dhe z. Vasid Bedinaj (Bashkia Vlorë), janë shprehur gjatë takimeve me stafin e KZLNDQ-së për një mbulim jo të balancuar të fushatave të tyre përkatëse nga mediat kombëtare.

5.3 Institucionet publike dhe përdorimi i fondeve në kuadër të zgjedhjeve lokale 2015

Sipas raportimeve të vëzhguesve të KZLNDQ, mund të pohojmë se ka disa raste ku dyshohet se partitë politike ushtrojnë presion mbi administratën qendrore apo vendore, për t'u bërë pjesë e aktiviteteve gjatë fushatës zgjedhore. Vëzhguesit e KZLNDQ kanë marrë informacion nga bashkëbiseduesit në lidhje me pesë raste të presionit mbi stafin e administratës publike, studentët ose të punonjësit e kompanive shtetërore për të marrë pjesë në mitingje dhe aktivitete zgjedhore. Megjithatë, vëzhguesit tanë nuk kanë mundur të verifikojnë këtë informacion.

Nëse këto dyshime rezultojnë të jenë të sakta, KZLNDQ do të informojë publikun në deklaratat e ardhshme.

Në pak raste (katër), vëzhguesit e KZLNDQ kanë parë që punonjësit e administratës publike dhe agjencive qendrore apo vendore kanë mbështetur kandidatët e partive politike gjatë orarit të punës. Për shembull, vëzhguesi ynë i KZAZ- nr.62 (Ura Vajgurore) ka raportuar se ka parë punonjësit e pushtetit vendor dhe mësuesit në mitingun e kandidatit të forcës politike të majtë.

Më tej, vëzhguesi ynë në KZAZ nr. 67 (Pogradec) ka parë punonjësit e institucioneve shtetërore duke e lënë punën e tyre në institucionet e qeverisjes vendore gjatë orarit zyrtar për të shkuar drejt zyrave elektorale të partive politike. Nga raportimet mbi KZAZ nr. 81 (Vlorë) punonjësit e sektorit të kujdesit shëndetësor kanë marrë pjesë në takimin elektorale të kandidatit të forcës së majtë gjatë orarit të punës. Përveç kësaj, në fushatën zgjedhore të Vlorës vëzhguesit afatgjatë raportojnë se punonjësit e transportit urban kanë marrë pjesë në takimin e kandidatit të majtë (datë 02.06.15 në 12:40).

Pavarësisht të drejtës që gjithkush ka për të patur mendim të lirë politik dhe për t'u përfshirë në fushatë zgjedhore, në këtë rast bëhet fjalë për një shkelje të Kodit Zgjedhor i cili në dispozitat e tij ndalon punonjësit e pushtetit qendror ose vendor për të marrë pjesë në aktivitete elektorale politike gjatë orarit zyrtar të punës.

KZLNDQ shqetësohet gjithashtu në lidhje me raportet e shumta të mediave të ceremonive, ku qeveria ka shpërndarë tituj legalizimit të pronës, ngjarje të cilat nuk dallohen qartë nga aktivitetet elektorale. Angazhimi i tillë i pushtetit qendror duhet të ndahet nga fushata elektorale meqë ndodh në të njëjtën periudhë. Vëzhguesit tanë gjithashtu kanë raportuar rastin e dërgimit të ndihmave humanitare për familjet e përmbytura në nëntor 2014 në komunën Qendër, në Vlorë. Periudha në të cilën kjo asistencë jepet, gjatë fushatës zgjedhore, ngre pyetje dhe shqetësime mbi ndikimin e mundshëm mbi përfutuesit.

Në përgjithësi, kandidatët dhe forcat politike kanë gëzuar mundësi të barabarta në përdorimin e ndertesave publike, kur përdorimi i tyre është i lejuar për fushatë. Autoritetet lokale gjithashtu kanë respektuar ekuilibrin në ndarjen e hapësirës për vendosjen e materialeve të tyre propagandistike.

Së fundi, KZLNDQ dëshiron të tërheqë vëmendjen e autoriteteve në lidhje me akuzat e bëra publike nga zonja Voltana Ademi, kandidatë e PD për Shkodrën, në lidhje me abuzimet e

sistemit TIMS për emigrantë fiktive që hyjnë në vend. Nëse këto akuza qëndrojnë, atëherë ky është një problem kombëtar dhe jo vetëm për rajonin e Shkodrës në lidhje me zgjedhjet lokale. KZLNDQ pret nga autoritetet përkatëse të kryejnë hetim të shpejtë të këtyre akuzave dhe të sigurojnë qytetarët për integritetin e votës së tyre. KZLNDQ pret përfundimin e hetimeve nga ana e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e transferimit të votuesve në Durrës dhe Kavajë, të cilat, në qoftë se rezultojnë të jenë të vërteta, do ta rrezikojnë seriozisht kredibilitetin e procesit zgjedhor në Shqipëri. KZLNDQ u bën thirrje autoriteteve për të hetuar të gjitha rastet e përmendura më lart.

###



6. Kush është KZLNDQ

Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ) është një koalicion i pavarur, jopartiak, i krijuar me qëllim nxitjen e pjesmarrjes së qytetarëve në votime dhe vëzhgimin e proceseve zgjedhore. KZLNDQ i kushton vëmendje të veçantë të drejtave të njeriut para ligjit, çështjeve që ndikojnë tek votuesit me aftësi të kufizuara si dhe çështjet e barazisë gjinore.

KZLNDQ ka nënshkruar Deklaratën Globale të Parimeve të Vëzhgimit Zgjedhor të Paanshëm nga Qytetarët dhe Kodin e Sjelljes të GDNEM (Rrjetit Global të Vëzhguesve Vendas për Monitorimin e Zgjedhjeve, që parashtron qartësisht parimet dhe kodin e sjelljes për monitorimin e pavarur të zgjedhjeve nga organizatat qytetare.

Metodologjia e vëzhgimit të zgjedhjeve të KZLNDQ është në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare bazuar në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, Konventa e OKB për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Deklarata e Parimeve Globale për Vëzhgimin e Paanshëm.

Projekti i KZLNDQ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015 mbështetet nga Assist Impact nëpërmjet fondeve të USAID-it. Në procesin e vëzhgimit të Zgjedhjeve Lokale në Shqipëri 2015, KZLNDQ po asistohet teknikisht nga Instituti Demokratik Amerikan, NDI.

KZLNDQ, bazuar në të dhënat e datës 6 qershor 2015, përbëhet nga 30 organizata partnere dhe nga qindra vullnetarë në të gjithë Shqipërinë.

Për më shumë informacion, ju lutemi të shihni portalin online www.kzln.org.al ose të kontaktoni:

Mirela Arqimandriti, drejtuese e projektit të vëzhgimit të zgjedhjeve.

Erjona Mulellari, drejtore ekzekutive.

Dhimëtr Gjodede, koordinator i vëzhguesve afatgjatë

Email: kzln@kzln.org.al Cel: 00355 68 20 59 301 ; 0684046770

Website: www.kzln.org.al

Facebook: Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme

Twitter: KZLN_CFFE_Albania

Aneksi 1 Tabela e KZAZ-ve në të gjithë Shqipërinë

Bashkia	Njësia Adm.	KZAZ	Bashkia	Njësia Adm.	KZAZ	Bashkia	Njësia Adm.	KZAZ
Malësi e madhe	Koplik	1	Tiranë	Nj. Bashkiake nr. 1	31	Mallakastër	Ballsh	61
Shkodër	Shkodër	2		Nj. Bashkiake nr. 2	32	Ura vajguore	Ura vajguore	62
	Shkodër	3		Nj. Bashkiake Nr. 3	33	Kuçovë	Kuçovë	63
	Shkodër	4		Nj. Bashkiake Nr. 4	34	Berat	Berat	64
	Shkodër	5		Nj. Bashkiake Nr. 5	35	Poliçan	Poliçan	65
	Vau i dejës	Bushat		6	Nj. Bashkiake nr. 6	36	Skrapar	Çorovodë
Pukë		7		Nj. Bashkiake nr. 7	37	Pogradec	Pogradec	67
Fushë arrëz		8		Nj. Bashkiake Nr. 8	38	Maliq	Maliq	68
Tropojë	Bajram curri	9		Nj. Bashkiake Nr. 9	39		Pustec	69
HAS(Krumë)	Krumë	10		Nj. Bashkiake Nr. 10	40	Devoll	Bilisht	70
KUKËS	Kukës	11		Nj. Bashkiake Nr. 11	41	Korçë	Korçë	71
LEZHË	Lezhë	12	Kavajë	42	Korçë		Korçë	72
	Lezhë	13	Rrogozhinë	43	Kolonjë	Ersekë	73	
KURBIN	Laç	14	Peqin	44	Këlcyrë	Përmet	74	
MIRDITË	Rrëshen	15	Belsh	45	Përmet	Këlcyrë	75	
Mat	Burrel	16	Cërrik	46	Memaliaj	Memaliaj	76	
Klos	Klos	17	Elbasan	Elbasan	47	Tepelenë	Tepelenë	77
Bulqizë	Bulqizë	18		Elbasan	48	Gjirokastër	Gjirokastër	78
Dibër	Peshkopi	19		Elbasan	49	Libohovë	Libohovë	79
Krujë	Krujë	20		Elbasan	50	Dropull	Jorgucat	80
Durrës	Sukth	21		Gramsh	51	Vlorë	Vlorë	81
	Durrës	22	Librazhd	52	Vlorë		82	
	Durrës	23	Prrenjas	53	Vlorë		83	
	Durrës	24	Lushnjë	54	Vlorë		84	
Shijak	Shijak	25	Lushnjë	55	Selenicë		Kotë	85
Vorë	Vorë	26	Divjakë	56	Himarë	Himarë	86	
Kamëz	Kamëz	27	Fier	Fier	57	Delvinë	Delvinë	87
	Paskuqan	28		Fier	58	Sarandë	Sarandë	88
Tiranë	Kashar	29	Patos	59	Livadhja	Dermish	89	
	Bërzhitë	30	Roskovec	60	Konispol	Konispol	90	

